

**AKT  
THEMELIMI I  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“PetrolBio Consulting” Shpk**

Ortaku themelues:

**Giancarlo Miotto** nenshtetas italian, i biri i **Miotto Luigi**, i datelindjes 15/03/1942, lindur ne Venezia (VE), Itali dhe banues ne, Via G. Falcone e P. BORSELLINO n. 2/A, Mogliano Veneto (TV), Itali, person madhor, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i Kartes se Identitetit me nr. YA7465651.

me deshiren dhe vullnetin e tij te lire, ne perputhje me Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te krijojte nje shoqeri tregtare mbeshtetur ne dispozitat e meposhtme:

Neni 1

Shoqeria tregtare qe krijohet emerohet **“PetrolBio Consulting” Shpk**. Emertimi tregtar vendoset ne te gjitha aktet dhe dokumentat e shoqerise ne marredheniet me persona te trete, si dhe ne vulen zyrtare te saj.

Neni 2

Selia qendrore e shoqerise eshte ne Tirane ne adresen ne Rruga: “Mine Peza”, Hyrja 1, Apartamenti N/3, Zona Kadastrale 8350, Pasuria Nr.4/6-N/3. Selia qendrore e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise apo edhe jashte saj, nepermjet degeve, filialeve, agjencive apo zyrave te perfaqesimit, kompetencat e te cilave percaktohen nga Asambleja e Ortakeve.

Neni 3

Shoqeria **“PetrolBio Consulting” Shpk** krijohet ne formen e “shoqerise me pergjegjesi te kufizuar” ne te cilen ortaku mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara sipas dispozitave qe parashikon ligji.

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte me afat te pakufizuar. Ky afat mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Shoqeria fiton personalitetin juridik dhe mund te filloje veprimtarine e saj mbas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.



## Neni 5

Objekti i veprimtarise se Shoqerise tregtare “**PetrolBio Consulting**” Shpk. eshte:

Ndërmjetësimi dhe tregti me shumice e naftes, Biokarburante, gazit, GNL & nenprodukteve te tyre, vajrave lubrifikante , transporti kombetar e nderkombetar i tyre, import-eksport dhe tregti me shumice te teknologjise&telefonise dhe pjeseve te kembimit per ushtrimin e veprimtarise hidrokarbure , te automjeteve te transportit hidrokarbur , ndertimin dhe venien ne perdorim te depove hidrokarbure , rezervuareve te linjave dhe pikave te shitjes se tyre sipas projektit teknologjik, licensa per blerjen-shitjen e energjise, license per blerjen e telefonise me shumice brenda&jashtevendit, ndertimin e depo stacionare per karburante e nenprodukteve te tyre, agjensi turistike, doganore, spedicionere, te transportit tokesor, detar e ajror civil, te pasagjereve e mallrave. E afte te futet ne çdo lloji koncesioni publik&privat me autorizim per te gjithë aktivitetet e lartpermendura,perfshire shit-blerjen/marrje me qira e tokave bujqesore&industriale , duke mundesuar import-eksport te burimeve nentokesore, brenda&jashtevendit, me financime nga jashte&Brenda vendit. Shit-blerja e mjeteve te lundrimit, fumizim i mjeteve lundruese me materiale, furnizime ushqimore, uje; organizim i guidave turistike, promocion i linjave te kroçierave ne portet e Shqiperise. Kryen operacione komerciale, financiare & industriale. Fumizim me karburant dhe lubrifikant per mjetet lundruese (detare) si dhe Jet-Oil per mjetet fluturuese ajrore.

## Neni 6

Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte ne vleren 580.000 (Peseqind e Tetedhjete mije) leke. Kapitali i shoqerise eshte ndare ne 1 (nje) kuote (pjese), me vlere 580.000 (Peseqind e Tetedhjete mije) leke. Nje kuote ka gjithashtu vleren e nje vote ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve.

Ne momentin e krijimit, kapitali i regjistruar i shoqerise eshte shlyer teresisht nga ortaku themelues i shoqerise dhe kuotat do te zoterohen nga ortaku i vetem :

- a) **Giancarlo Miotto**, zoterues i 100 % te kapitalit themeltar te Shoqerise ose 1 kuotë (pjese) me vlere te pergjithshme 580.000 (Peseqind e Tetedhjete mije) Leke te shoqerise “**PetrolBio Consulting**” Shpk.

## Neni 7

Organi me i larte drejtues dhe vendimmarres i shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve, e thirrur dhe mbledhur ne menyre te ligjshme, e cila perfaqeson teresisht teresine e ortakeve te shoqerise.

Kompetencat e Asamblese se Ortakeve percaktohen nga ligji dhe Statuti i Shqoqerise.



Asambleja i ushtron kompetencat nepermjet vendimeve, qe merren prej saj sipas kuorumit te krekuar prej ceshtjes te caktuar, kourum, i cili percaktohet nga ligji dhe Statuti.

#### Neni 8

Shoqeria administrohet nga nje ose me shume administratore, me mandat 5 vjecar me te drejte riemerimi, te cilet edhe mund te mos jene ortake ne shoqeri. Nese Asambleja e pergjithshme emerom me shume se nje administrator, ata e administrojne shoqerine ne menyre autonome.

Kompetencat e Administratoreve percaktohen nga ligji, Statuti ose aktet e tjera te brendshme te shoqerise.

Emerimi dhe shkarkimi i administratoreve behet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve me shumice te zakonshme.

#### Neni 9

Shoqeria per ushtrimin e aktivitetit te saj krijon dhe disponon fondet e nevojshme, perfshire fondin rezerve dhe fonde te tjera per zhvillim. Perberja, madhesia, burimet e krijimit dhe perdorimi i çdo fondi ne perputhje me rrethanat, interesat dhe objektin e veprimtarise se shoqerise, vendosen nga Asambleja e Ortakeve duke respektuar legjislacionin ne fuqi.

#### Neni 10

Veprimtaria ekonomike e shoqerise ndahet ne periudha financiare 12 mujore. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 dhjetor te cdo viti kalendarik, me perjashtim te vitit te pare, i cili fillon nga data e krijimit te shoqerise dhe mbaron me 31 dhjetor.

Ne mbyllje te vitit financiar, ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi, shoqeria harton dhe paraqet ne organet tatimore, bilancet financiare.

Administratori hartojn raportin mbi administrimin, gjendjen financiare, llogarite vjetore dhe inventaret e shoqerise, te cilat ja paraqesin per miratim Asamblese se Ortakeve brenda 6 mujorit te pare te viti pasardhes.

#### Neni 11

Veprimtaria e Shoqerise mbaron me vendim te Asamblese se Ortakeve ne rast se nuk eshte e mundur te realizohet objekti i veprimtarise se Shoqerise, ne rast se kjo veprimtari rezulton me humbje te vazhdueshme ose ne raste te tjera qe parashikon ligji.

Kur vendoset mbyllja e aktivitetit te shoqerise, ne çfaredo kohe dhe per çfaredo arsye, emerohet nje ose me shume likujdatore per te ndjekur dhe perfunduar procedurat e likujdimit ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ne perfundim te procedurave te likujdimit, pasuria e Shoqerise qe mbetet pas shlyerjes



se te gjitha detyrimeve ndaj te treteve, do te shperndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me pjesen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

#### Neni 12

Si rregull, cdo mosmarreveshje ortaket do ta zgjidhin me mirekuptim midis tyre. Ne rast te kundert, kompetente oer zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane.

#### Neni 13

Veprimtaria e shoqerise ne teresi do te rregullohet nepermjet Statutit dhe Akteve te tjera te brendshme te shoqerise si dhe Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe legjislacionin shqiptar ne teresi.

**ORTAKU I VETEM  
I SHOQERISE TREGETARE  
"PetroBio Consulting" Shpk**

**Giancarlo Miotto**  


**Tirane me: 30 / 12 / 2022**